




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC
OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria e Arsimit

04 Nr. 234

Më: 11.05.2023

Duke u bazuar në UA nr.02/2016 Për Aktivitetet Jashtëshkollore i dt.12/01/2016, ofertën me numër protokollit 04/232 i dt.06/05/2022 lidhur me organizimin e ekskursionit për maturantë në SHMLM "Hysni Zajmi" në Gjakovë, për bartjen e nxënësve në Republikën e Shqipërisë me qëndrim në Durrës. Nga Durrësi vizitohen: Vlora, Krujë, Tirana, Berati dhe Durrësi. Ekskursioni zgjat 4 bujtje (gjithsejt katër bujtje pansion i plotë) prej datës 22/05/2023 deri më 26/05/2023.

Lista e konkurrentëve për të fituar ofertën për ekskursion të maturantëve të SHMLM "Hysni Zajmi" në Gjakovë, janë :

- 1.N.P.T. "Kushtrimi NM I" me çmim 152.00 €;
2. SH.K.P. "Meti Tours" me çmim 145.00 € ;
3. SH.P.K. "Meti Comerc " me çmim 135.00€ ;
4. SH.P.K. "Bledi Bus" me çmim 120.00 € ;
- 5.SH.P.K."Armendi Tours" me çmim 105.00 € ;

Raport i Komisionit selektues:

Hapja e ofertave u bë me dt.05/05/2023 në ora 9:00 sipas ofertës nr.04/998 i dt.28/04/2023 ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e SHMLM "Hysni Zajmi" dhe Drejtorisë së Arsimit :

1. z.Gjokë Tahiri - Drejtor i Shkollës "Hysni Zajmi" në Gjakovë – Kryesues
2. z.Demir Bajra - Përfaqësues i Këshillit Drejtues të Shkollës "Hysni Zajmi" në Gjakovë- Anëtarë
3. znj.Flutur Këpuska Zyrtare e DKA-së - anëtare

Të gjitha ofertat janë hapur dhe lexuar në praninë e kompanive konkurruese.

Firma transportuese N.P.T. "Kushtrimi NM I" ka konkuruar me çmim prej 152.00€, për nxënës ku iu është ofruar qëndrimi në hotel "Kamomil" në Golem - Durrës. Në ofertë përfshihen katër (4) bujtje por i mungon menuja.Vizitat në qytetet e Republikës së Shqipërisë bëhen me marrëveshje në mes të palëve kontraktuese.

Posedon Liçencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, liçencë kjo e vlefshme nga dt.15/04/2021 gjer më dt.14/04/2026 , posedon Çertifikatën e Mjekut për perkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës "Hysni Zajmi" në Gjakovë, ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit të biznesit dhe Vërtetimin Tatimor, Letër Referencat gjithashtu ka prezantuar Çertifikatë e Akreditimeve të ushqimeve të Hotelit "Kamomil" me NIPT:L717035005L pronar Jorida Zoga por agjensis "Kushtrimi" N.P.T. i mungon Konfirmim Rezervimi nga Hoteli në fjalë . Për transportin e nxënësve ka përfshirë 2 shoferë dhe 2 autobusë ku sipas ofertës për ekskursion nuk i plotëson kushtet, pasi numri i nxënësve është rreth 230 nxënës.



Firma transportuese SH.P.K. "Meti -Tours" ka konkuruar me çmim prej 145.00€, për nxënës ku iu është ofruar qëndrim (akomodim) në Hotel "AS" por i mungon menuja.Vizitat në qytetet të Republikës së Shqipërisë si në Tiranë, Krujë, Vlorë dhe Berat.

Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, liçencë kjo e vlefshme nga dt.07/06/2019 gjerë më dt.06/06/2024.

Ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit të kompanisë.

Nuk posedon Çertifikatën e Mjekut për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës. Janë të përfshirë 2 shoferë dhe 2 autobusë por jo të pajisur me Çertifikatën mjekësore që janë kërkuar në ofertë. Ka mungesë të dokumentacionit.

Firma transportuese SH.P.K. "Meti Comerc" ka konkuruar me çmim prej 135.00€ për nxënës gjithashtu ka ofruar 10 persona gratis, akomodimi i nxënësve do të jetë brenda një kompleksi hotelier .

Oferta bazohet në 4 (katër) bujtje me pansion të plotë ku ju është ofruar qëndrim në Hotel "Bonita" , ndërsa vizita qyteteve të Republikës së Shqipërisë bëhen me marrëveshje në mes të palëve kontraktuese. Janë të përfshirë gjashtë (6) shoferë të pajisur me certifikatë mjekësore dhe janë prezantuar 7 autobusë.

Posedon Liçencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, liçencë kjo e vlefshme nga dt.08/03/2021 gjer me dt.07/03/2026 , ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit,të biznesit ,Licencën e Punës Dr.Baton Lleshi së bashku me kontratën e punës të kontraktuar nga kompania "Meti Comerc" për kryerjen e shërbimeve mjekësore për nxënësit (maturant), Letër Referencën ,Vërtetimin Tatimor. Gjithashtu Kompania "Meti Tours" ka prezantuar Kontratë bashkëpunimi me Hotel "Bonita" administrator z.Astrit Ismaili bashkangjitur edhe Licencën e Agjensionit të Akreditimeve të Ushqimeve të hotelit "Bonita "me NIPT: K52610802N mirëpo data e akomodimit (dt.21.05.203 deri më 25.05.2023) nuk përkon me datën e Ofertës nga shkolla.

Firma transportuese SH.P.K. "Bledi Bus" ka konkuruar me çmim prej 120.00€, për nxënës ku iu është ofruar qëndrim (akomodim) në Hotel Bonita Luxury " Kavaj mirëpo agjensia "Bledi Bus" Konfirmim rezervimin e ka bërë me " Kompleksin Bonita" Golem –Kavajë. Në ofertë përfshihen katër(4) bujtje me pansion të plotë që nga dt.22/05/2023 gjerë më dt.26/05/2023.Vizitat në qytetet e Republikës së Shqipërisë bëhen me marrëveshje në mes të palëve kontraktuese.

Posedon Liçencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, liçencë kjo e vlefshme nga dt.22/06/2021 gjer më dt.21/06/2026, posedon Çertifikatën e Mjekut mirëpo kontrata me mjekun nuk është e lidhur me shkollën "Hysni Zajmi" por me shkollën "Kadri Kusari" në Gjakovë, ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit të biznesit. Për transportin e nxënësve ka përfshirë 5 shoferë dhe 4 autobusë dhe 1 minibus me 18 ulëse, që posedojnë Çertifikatën mjekësore për shofer dhe shiqimin teknik të autobusëve. I mungon Çertifikata e Akreditimeve të Ushqimeve për Hotel "Kompleksi Bonita" sipas konfirmim rezervimit që e ka bërë firma "Bledi Bus" SH.P.K.

Firma transportuese SH.P.K. "Armendi -Tours"-Gjakovë ka konkuruar me dy oferta, sipas ofertës së parë çmimi është 110,00€ për Hotelin "Bonita Luxury" Golem ,mirëpo i mungon Konfirmim rezervimi së bashku me Çertifikatën e Akreditimit të Ushqimeve me Hotelin në fjalë.

Oferta e dytë është me çmimin 105.00€ në Hotelin "Kamelia Resort" Durrës mirëpo i mungon Çertifikata e Akreditimeve të Ushqimeve për hotelin në fjalë. Në ofertë përfshihen katër (4) bujtje me pansion të plotë që nga 22/05/2023 deri më 26/05/2023 dhe vizitat në qytetet e Republikës së Shqipërisë në Vlorë, Krujë, Tiranë dhe qytetin e Durrësit dhe gjithashtu ofron transportin gratisë për mbrëmjen e maturës . Firma ofron pishina të brendshme dhe të jashtme të gjitha në shërbim të nxënësve dhe stafit të shkollës.

Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.28/02/2022 gjer me dt.27/02/2027. Posedon Çertifikatën e Mjekut dr.Baton Lleshi ku është lidhur marrëveshja mes tij dhe firmës transportuese SHPK "Armendi -Tours" për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës "Hysni Zajmi" në Gjakovë. Janë të përfshirë 6 shoferë e të pajisur me çertifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 5 autobusë dhe 1 minibus. Gjithashtu

ka prezentuar Çertifikatën e Regjistrimit (ARBK 4 faqe) të firmës dhe kontrollin teknik 6 mujor të autobusëve sipas procedurave ligjore, Vërtetimin Tatimor dhe Komunal.

Ka prezentuar Konfirmim Rezervimi nga Kompleksi "Bonita" të vërtetuar nga pronari Astrit Ismaili së bashku me Licencën e Agjensionit të Akreditimeve të Ushqimeve -Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)- Republika e Shqipërisë (neni 11 paragrafi 2.21 i UA -02/2016) sipas ofertës nr.prot.04/998 dt.28.04.2023 mirëpo nuk përkon me Ofertën e prezentuar nga "Armendi Tours" të Hotelit Bonita Luxury" në Golem. Gjithashtu edhe në ofertën e dytë ka prezentuar Konfirmim Rezervimin që nuk përkon me të njëjtin Hotel për akomodimin e nxënësve.

Vlerësimi i Komisionit selektues:

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firmat konkurruese, Komisioni selektues ka kërkuar të njoftohen anëtarët e KDSH me nënkryetar z.Avdi Gashi lidhur me ndryshimin e datës së ekskursionit nga data 22.05.2023 -26.05.2023 në datën 21.05.2023-25.05.2023 pasi ofertuesi i vetëm që ka plotësuar kushtet e ofertës ka rezervuar hotelin me datën 21.05.2023,të gjithë të pranishmit ishin dakort sipas Procesverbalit dt.08.05.2023. Gjithashtu më dt.10.05.2023 është mbajt mbledhja e Këshillit të Prindërve ku janë njoftuar prindërit e fëmijëve pjesëmarrës në ekskursion lidhur me ofertat. Nga prindërit është kërkuar Pëlqimi për përzgjedhjen e kompanisë për organizimin e ekskursionit, ku komisioni selektues me dt.10.05.2022 iu janë prezentuar Pëlqimet e Prindërve të Nxënësve të Klasave të 12-ta si dhe Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasave të 12-ta.

Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Shkollën "Hysni Zajmi" në Gjakovë të përzgjedhet firma SH.P.K. "Meti Comerc" me çmim prej 135.00€ me pronar z.Zenel Musa".

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi ta zgjedhë agjencinë turistike SH.P.K. "Meti Comerc" Menaxher z.Zenel Musa nga Gjakova.

Arsyetim

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firmat konkurruese, Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasëve të 12-ta, Pëlqimit të Këshillit të Prindërve për secilën klasë veç e veç (për 10 klasë), listave për aprovimin e ekskursionit të nënshkruara nga prindërit e të gjithë nxënësve që do të marrin pjesë në ekskursion, Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Shkollën "Hysni Zajmi" në Gjakovë të përzgjedhet firma SH.P.K."Meti Comerc" me çmim prej 135.00€. Gjithashtu hoteli i prezentuar nga agjencia turistike ofron siguri të mjaftueshme që të mos ketë hyrje dhe dalje nga persona të pa autorizuar (rrethoja) të paraparë sipas pikës 8 të Kërkesës për ofertë me numër të protokollit 04/998 i dt.28/04/2023 të shkollës "Hysni Zajmi" në Gjakovë.

Kompania e përzgjedhur në fjalë është e obliguar që nxënësit e SHMLM "Hysni Zajmi" Gjakovë që t'i respekton të gjitha zotimet në ofertë.

Komisioni selektues:

1.Gjokë Tahiri
(emri dhe mbiemri)

Kryesues i Komisionit
(pozita)

dt.11/05/2023



2.Demir Bajra
(emri dhe mbiemri)

Anëtar
(pozita)

dt.11/05/2023



3.Flutur Këpuska
(emri dhe mbiemri)

Anëtare
(pozita)

dt.11/05/2023



Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 7 ditësh, prej ditës së pranimit të së njëjtit. Ankesa i adresohet Sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

Vendimi iu dërgohet:

- Agjencie turistike
- Komisionit të Ankesave
- Shërbimit juridik
- Arkivit

